



www.legjisllacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 7

Tiranë – E hënë, 20 mars 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 10156, datë 14.12.2016	Me objekt mbylljen e procedurave të falimentimit për debitorin, shoqëria “Italkrom Albania” sh.p.k.....	3
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 64, datë 14.3.2017	Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës “Analizat e kërkesave dhe përgatitja e specifikimeve teknike për zbatimin e Sistemit të Informacionit në spitalet rajonale në Shqipëri”.....	6



VENDIM

Nr. 10156, datë 14.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË,
E PËRBËRË NGA:
MARINELA OSMANI - GJYQTARE

Asistuar nga sekretare gjyqësore Valbona Maja, sot në datën 14.12.2016, përfundoi me dyer të hapura, çështjen tregtare nr. 4140, që i përket:

KËRKUES: Administratorja e Falimentimit Mimoza Cara.

DEBITORI: Shoqëria “ItalKrom Albania” sh.p.k., me seli në Tiranë, adresa: rruga “Andon Zako Çajupi”, nr. 11.

OBJEKTI: Mbyllja e procedurave të falimentimit për debitorin, shoqëria “ItalKrom Albania” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar

Gjykata, në përfundim të mbledhjes së kreditorëve, të realizuar në datën 14.12.2016, pasi çmoi raportin e paraqitur nga administratorja e falimentimit Mimoza Cara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Me kërkesën drejtuar kësaj Gjykate, të protokolluar me nr. 17488, datë 22.11.2016, pala kërkuese, administratorja e falimentimit Mimoza Cara, kërkon mbylljen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k.

2. Mbi këtë kërkesë, Gjykata disponoi për thirrjen e mbledhjes për dëgjimin e kreditorëve dhe debitorit në lidhje me mbylljen e procedurës, në datën 9.12.2016. Në mbledhjen e datës 9.12.2016 pjesëmarrësve iu dha një kopje e raportit të administratores për t’u njohur dhe paraqitur vërejtje në shqyrtimin e tij, në mbledhjen e datës 14.12.2016.

Gjatë shqyrtimit të raportit, në mungesë të vërejtjeve ndaj tij të pjesëmarrësve në procedurën e falimentimit dhe akteve të tjera, rezultoi e provuar se:

3. Shoqëria “ItalKrom Albania” sh.p.k. është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në datën 5.11.2007. Kjo shoqëri ushtronte aktivitetin tregtar në fushën e kërkimit, eksplorimit dhe shfrytëzimit të mineraleve.

4. Me kërkesën drejtuar Gjykatës, kreditori Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, ka kërkuar hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., me vendimin nr. 11369, datë 13.11.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në prova dhe në ligj.

-

5. Mbi ankimin e palës kërkuese Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 75, datë 10.2.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 11369, datë 13.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e kërkesës për çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ItalKrom Albania” sh.p.k.

6. Menjëherë sapo kjo Gjykatë u njoh me këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore, konkretisht nenet si vijon:

Nenin 18/4, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), i cili parashikon: *“Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni vendos: c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit...”*.

Nenin 26, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), i cili parashikon: *“1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit. 2. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit përmban: a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personave juridikë; b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit; c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit; c) të dhënat e parashikuara në nenet 27 dhe 29 të këtij ligji; d) urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës... 4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të falimentimit...”*

dhe në kushtet kur është vendosur pranimi i kërkesës dhe hapja e procedurës së falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., vendosi vijimin e procedurës me vendimmarrjen e datës 7.12.2015, me të cilën vendosi:



1. Emërimin si administratore të falimentimit, për shoqërinë “Italkrom Albania” sh.p.k., të znj. Mimoza Cara, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 13, datë 16.10.2012, me adresë: bulevardi “Zogu I”, Qendra e Biznesit Veve.

2. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., të paraqesin pranë administratorës së falimentimit, pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

3. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

4. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratorës së falimentimit znj. Mimoza Cara.

5. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

6. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

7. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

8. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., t’i njoftohet administratorës së falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., Mimoza Cara.

9. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

14. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

15. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shqip”.

7. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar mbledhja për raportim dhe verifikim, të cilat janë finalizuar me miratimin e tabelave të verifikimit të pretendimeve të kreditorëve. Procedura u zhvillua në mungesë të debitorit, me gjithë përpjekjet e administratorës së falimentimit për njoftimin e tij.

8. Sipas raportit të administratorës, procedura e falimentimit i është referuar bilancit të vitit 2007. Në datën e hapjes së procedurës së falimentimit nuk ka një informacion mbi detyrimet e shoqërisë, por sipas bilancit të vitit 2007, janë paraqitur nga drejtimi i shoqërisë detyrime në shumën 171,606,385 lekë:

- furnitorë:	160,926,983 lekë;
- detyrime ndaj personelit për paga të paguara:	5,176,040 lekë;
- detyrim për tatime të tjera:	1,257,243 lekë;
- detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore:	4,246,119 lekë.

9. Gjatë periudhës nga hapja e procedurës së falimentimit e deri në mbylljen e saj, nga ana e administratorës së falimentit, nuk janë kryer deklarimet tatimore për shkak të mosparaqitjes së drejtuesve të shoqërisë për të bërë dorëzimin e



aktivitetit të saj. Për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe inventarëve të aktiveve dhe pasiveve, u hasën pengesa në verifikimin e pretendimeve të kreditorëve. Konkretisht, pas mbledhjes për raportim të kreditorëve u zhvilluan dy seanca për verifikimin e pretendimeve të kreditorëve për t'i lënë kohë kreditorit “Intesa San Paolo Bank” për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm që provonte dhënien e kredisë shoqërisë, si dhe masat që ishin marrë nga ana e saj për vjeljen e kësaj kredie.

10. Në kushtet e mosgjatjes së masës së falimentimit dhe në kushtet e mosparaqitjes së organit administrues dhe pronarit të shoqërisë për dorëzimin e aktivitetit, puna e administratorës së falimentimit u përqendrua në verifikimin e dokumentacionit të paraqitur për pretendimet e kreditorëve.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës dhe pas analizës së faktit dhe analizës së parashikimeve në ligj, Gjykata vëren se:

11. Procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paafësisë pagueuse apo mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij, do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani shëndetësimi për këtë subjekt, në rast se arrihet në përfundimin se një veprim i tillë është i mundur.

12. Në rastin konkret, rezultoi se shoqëria “ItalKrom Albania” sh.p.k., nuk provohet të ketë pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, të cilat do t'i nënshtrohen procesit të likuidimit dhe më pas të shpërndarjes. Për pasojë, të gjithë kreditorët, pretendimet e të cilëve u verifikuan rregullisht dhe u vërtetuan gjatë kësaj procedure, nuk u shlyen nga masa e falimentimit për shkak të mungesës së saj. Mungesa e bilanceve pas vitit 2007 bënë të pamundur për administratoren e falimentimit dhe për Gjykatën, pasjen e një tabloje të plotë dhe të saktë të të gjitha lëvizjeve financiare të shoqërisë, duke ngarkuar me përgjegjësi për këtë fakt, subjektet drejtuese dhe zotëruese të kuotave të shoqërisë.

13. Sa më lart, Gjykata çmon mbylljen e procedurës së falimentimit të debitorit shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., me NIPT 72305024J, me seli në Tiranë, adresa: rruga “Andon Zako Çajupi”, nr. 11. Publikimi i

vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të debitorit shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., do të bëhet në Buletinin Zyrtar të Njoftimeve Publike. Gjithashtu, publikimi i këtij vendimi, do të bëhet dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të debitorit shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., do t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të përfunduar procedurat në lidhje me çregjistrimin e kësaj shoqërie pranë këtyre institucioneve, në përputhje me legjislacionin përkatës të zbatueshëm.

14. Gjykata çmon dërgimin e një kopje të vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të debitorit shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., bashkë me raportin përfundimtar të administratorës së falimentimit Mimoza Cara, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për verifikimin e konsumimit të veprave penale në fushën e shoqërive tregtare dhe të falimentimit.

15. Për efekt të shpenzimeve të procedurës, Gjykata çmon njohjen si procedurë falimentimi e kryer pa shpërblim nga ana e administratorës së falimentimit Mimoza Cara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata bazuar në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së falimentimit të debitorit shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., me NIPT 72305024J, me seli në Tiranë, adresa: rruga “Andon Zako Çajupi”, nr. 11.

2. Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të debitorit shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., në Buletinin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

3. Urdhërohet publikimi i këtij vendimi, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.



4. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të debitorit shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit për të përfunduar procedurat në lidhje me çregjistrimin e kësaj shoqërie pranë këtyre institucioneve, në përputhje me legjislacionin përkatës të zbatueshëm.

5. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të debitorit shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., bashkë me raportin përfundimtar të administratores së falimentimit Mimoza Cara, t’i komunikohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për verifikimin e konsumimit të veprave penale në fushën e shoqërive tregtare dhe të falimentimit.

6. Njohjen si procedurë falimentimi e kryer pa shpërblim nga ana e administratores së falimentimit Mimoza Cara.

7. Kundër këtij vendimi ligji subjektet e procedurës mund të bëjnë ankim sipas rregullave të përgjithshme, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit publik apo shpalljes publike të vendimit, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

U shpall në Tiranë, sot në datën 14.12.2016.

SEKRETARE
Valbona Maja
GJYQTARE
Marinela Osmani

KËRKESË
E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
Nr. 64, datë 14.3.2017

PËR SHPREHJE INTERESI (REOI)
(SHËRBIME KONSULTUESE)

14 mars 2017

SHQIPËRI
PROJEKTI I PËRMIRËSIMIT TË
SISTEMIT SHËNDETËSOR (HSIP)
HUA NR.: 8466 AL.
NUMRI ID I PROJEKTIT: P144688

Titulli i detyrës: Analizat e kërkesave dhe përgatitja e specifikimeve teknike për implementimin e sistemeve të informacionit të spitaleve rajonale në Shqipëri

Referencë nr.: Ref. nr. HSIP/CS/CQ/10–2017

Qeveria shqiptare ka marrë një financim nga Banka Botërore kundrejt kostos së Projektit të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor (HSIP) dhe ka për qëllim të zbatojë pjesë të procedurave për shërbimet konsultuese.

Shërbimet konsultuese (“Shërbimet”) përfshijnë ***“Analizat e kërkesave dhe përgatitja e specifikimeve teknike për implementimin e sistemeve të informacionit të spitaleve rajonale në Shqipëri”***.

Konsulenti për analizat e kërkesave dhe përgatitjes të specifikimeve teknike për implementimin e sistemeve të informacionit të spitaleve rajonale në Shqipëri (nga këtu “Konsulenti”) pritet të ndihmojë Ministrinë e Shëndetësisë në konceptimin, dizajnimin dhe monitorimin e implementimit të Sistemit të Informacionit të Spitaleve (RHIS) në spitalet rajonale të përzgjedhura në Shqipëri. Kjo do të përfshijë:

- Vlerësim të detajuar të statusit aktual të menaxhimit të informacionit dhe analizat e kërkesave në spitalet rajonale;
- Konceptualizimin e RHIS-it;
- Specifikime funksionale dhe teknike të RHIS-it për prokurimin e komponentëve të RHIS-it;
- Supervizim teknik të zhvillimit dhe implementimit të RHIS-it.

Ekipi i ekspertëve të ketë të paktën ekspertizën e mëposhtme:

Konsulenti do të jetë përgjegjës, për:

- Vlerësim të detajuar të statusit aktual të menaxhimit të informacionit në spitalet rajonale. Konsulenti do të vlerësojë burimet aktuale dhe kapacitetet e të gjitha spitaleve të përfshira (lista e spitaleve të përfshirë është e paraqitur në aneksin 1) për procesimin dhe përhapjen e informacionit mjekësor dhe administrativ.

- Specifikimi i nevojave për zhvillimin e menaxhimit të informacionit mjekësor dhe administrativ. Konsulenti do të paraqesë analiza funksionale të detajuara të kërkesave dhe të sigurojë prezantim analitik të përmirësimeve të nevojshme përmes përdorimit të sistemeve të kompjuterizuara, mjetet dhe shërbimet.

- Konceptimi i RHIS-it. Konsulenti do të sigurojë dizajn konceptual të RHIS-it të ardhshëm që do të përfshijë specifikime logjike të funksioneve RHIS dhe komponentëve



(specifikime funksionale, nënsisteme, module, databaza dhe platformë sistemi). Konceptimi do të përfshijë, gjithashtu, këshillimin në menaxhimin e procesit të implementimit të RHIS-it (vlerësimet e kostove, propozim të planit të projektit, rekomandimet e ndryshimeve ligjore dhe rregullatore të nevojshme, këshilla në metodat e prokurimit etj.).

- Bazuar në aprovimin e koncept-projektit, Konsulenti do të zhvillojë specifikime teknike të detajuara për komponentët hardware/software të RHIS-it, që janë detaje të mjaftueshme për hapjen e procesit të tenderit për prokurimin e RHIS-it.

- Në momentin e kontraktimit të kompanisë, konsulenti do të jetë përgjegjës për supervizimin teknik të implementimit të kontratës, duke siguruar proces të verifikimit dhe miratimit të pavarur (IV&V).

Konsulencia do të kryhet nga një firmë konsulente lokale me eksperiencë të provueshme në shërbimet konsulente për projektet IT dhe udhëheqjen e korporatave dhe shërbimeve të

konsulencës për Modelimin e Procesit të Biznesit. Firma konsulente duhet të ketë të paktën tre ekspertë kyçë.

Lideri i ekipit – me eksperiencë të provuar në koordinimin e e-Qeverisjes në administrim publik, me eksperiencë në planifikim dhe implementimin e e-Qeverisjes në projekte ndërkombëtar dhe/ose shtete pjesëtare të EU-së.

Ekspert E-shëndetësor me eksperiencë ndërkombëtare – me mjeshtëri të provuar në sistemet E-shëndetësore.

Analist sistemi / ekspert i analizës të biznesit - ICT analist sistemi.

Ministria e Shëndetësisë, përmes Njësisë të Koordinimit të Projektit (PCU) fton tani firma konsulente lokale të përshtatshme/kompani (“Konsulente”), për të paraqitur interesin e tyre në sigurimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të sigurojnë informacion duke demonstruar që ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencë të mëparshme për të performuar këto shërbime.

Kriteret e shkurtuara të listuara, janë:

Nr.	Kriteret e vlerësimit	Pikët
1.	Ekspierienca e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në hartim, zbatim dhe vënien në punë të sistemeve të informacionit	30 pikët
2.	Numri i detyrave të ngjashme të mbaruara gjatë pesë viteve të fundit	35 pikët
3.	Ekspierencë në detyra relevante dhe kualifikimin e personelit kryesor	35 pikët
TOTALI		100 pikët

Vëmendja e konsulentëve të interesuar është paraqitur në paragrafin 1.9 të Bankës Botërore [Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i Konsulentëve nga Huadhënësit e Bankës Botërore](#) (janar 2011, rishikuar në korrik 2014), i vendosur sipas politikave të Bankës Botërore të konfliktit të interesit.

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është përzgjedhja e kualifikimit të konsulentëve (CQ), në përputhje me procedurat e nxjerra nga “Përzgjedhja e udhëzimeve dhe punësimit të konsulentëve, nënbatë IBRD dhe kreditë IDA dhe grantet nga Huadhënësit e Bankës Botërore” (janar 2011, rishikuar në korrik 2014).

Firma do të kontraktohet nën një kontratë *lump-sum*. Faza e dizenjimit të sistemit është menduar të implementohet brenda 26 javëve. Konsulenti pritet të fillojë shërbimin në prill 2017.

Informacion më i detajuar mund të merret në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00 deri në 16:30 (nga e hëna në të enjte) dhe 08:00 deri në 14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dërgohen në formë të shkruar në adresën e mëposhtme (personalisht ose me postë, ose me faks, ose me e-mail) jo më vonë se **30 marsi 2017**.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË (MSH)
Njësia e Koordinimit të Projektit (PCU)
Projekti i Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor (HSIP)

Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Blerina Dudushi

e-mail: hsip.dudushi@gmail.com

Në vëmendje të: Elma Dogani

e-mail: hsip.dogani@gmail.com



**REQUEST FOR EXPRESSIONS OF
INTEREST (REOI)
(CONSULTING SERVICES)**

March 14, 2017

ALBANIA

**ALBANIA HEALTH SYSTEM
IMPROVEMENT PROJECT (HSIP)
LOAN NO: 8466 AL.
PROJECT ID NUMBER: P144688**

Assignment Title: "Requirements Analysis and Preparation of Technical Specifications for Implementation of Regional Hospitals Information System in Albania"

Reference No. Ref. no. HSIP/CS/CQ/10-2017

The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Health System Improvement Project (HSIP), and intends to apply part of the proceeds for consulting services.

The consulting services ("the Services") include *"Requirements Analysis and Preparation of Technical Specifications for Implementation of Regional Hospitals Information System in Albania"*.

The consultant for Requirements Analysis and Preparation of Technical Specifications for Implementation of Regional Hospitals Information System in Albania (hereinafter "the Consultant") is expected to help the MoH in conceptualizing, designing and implementation monitoring of the Regional Hospitals Information System (RHIS) in selected regional hospitals in Albania. This will include:

- Detailed assessment of current status of information management and requirements analysis in regional hospitals.
- Conceptualization of RHIS.
- Functional and technical specifications of the RHIS for procurement of RHIS components.
- Technical supervision of RHIS development and implementation.

The team of experts has at least the following expertise:

The Consultant will be responsible for:

- Detailed assessment of current status of information management in regional hospitals.

The Consultant will assess the current resources and capabilities of all included hospitals (the list of included hospitals is provided in Annex 1) for processing and dissemination of medical and administrative information.

- Specification of needs for improvement of medical and administrative information management. The Consultant will perform detailed functional requirements analysis and provide analytical presentation of needed improvements through the use of computerized systems, tools and services.

- Conceptualizing the RHIS. The Consultant will provide conceptual design of future RHIS that will include logical specification of RHIS functions and components (functional specification, sub-systems, modules, database(s) and system platform). The conceptualization will also include advising on management of RHIS implementation process (estimates of costs, proposal of project plan, recommendations of needed legal and regulatory changes, advice on procurement method, etc.)

- Based on approved conceptual design, the Consultant will develop detailed technical specifications for hardware/software components of RHIS that are of sufficient details and quality for opening the bidding process for RHIS procurement.

- Once the RHIS components are contracted, the Consultant will be responsible for technical supervision of contracts' implementation, assuring Independent Verification and Validation (IV&V) process.

The consultancy will be carried out by a local Consultant Firm with proven experience in Consulting services for IT projects and corporate governance and Consulting services for Business Process Modeling. The Consultant firm must have at least three key experts

Team Leader - with proven expertise in e-Government coordination in Public Administration, with experience of e-Government planning and implementation in international project and/or EU Member State

E-health Expert with international experience - with proven expertise in E-health systems

System analyst / Business Analyst Expert - ICT System Analyst



The Ministry of Health, through Project Coordination Unit (PCU) now invites eligible local Consultant Firms/ Company (“Consultants”), to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants

should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The short listing criteria are:

No.	Evaluation Criterion	Points
1.	Overall experience of the firm (number of years) in design, implementation and operational of Information Systems	30 points
2.	Number of similar assignments completed during last five years	35 points
3.	Assignment-relevant experience and qualification of key personnel	35 points
TOTAL		100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank’s [Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers](#) (January 2011, revised July 2014), setting forth the World Bank’s policy on conflict of interest.

The consultant should be a Local Firm. The selection method to be applied is **Consultants Qualification Selection (CQ)**, in accordance with the procedures set out the World Bank’s “*Guidelines Selection and Employment of Consultants Under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers*” (January 2011, revised July 2014).

The firm will be contracted under a lump sum terms contract. System Design phase is expected to be implemented within 26 weeks. The consultant is expected to start the service on April 2017.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by fax, or by e-mail) no later than **March 30, 2017**.

MINISTRY OF HEALTH (MOH)
Project Coordination Unit (PCU)
Health System Improvement Project (HSIP)
 Tirana, Albania
 Att: Blerina Dudushi
 e-mail: hsip.dudushi@gmail.com
 Att: Elma Dogani
 e-mail: hsip.dogani@gmail.com

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2017